

## Kthimi i muslimanëve në Perëndim

يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاكُمْ مِنْ ذَكَرٍ وَأُنْثَىٰ وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ.

*“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur, e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë. (El-Huxhurat, 13).*

### Hyrje

Evropa perëndimore më shumë se një milenium ka qenë kristiane dhe kundrejt botës muslimane ajo është identifikuar si bërthamë e kristianizmit. Edhe sot e gjithë ditën, veçan në kohën e krizave politike-fetare dhe të pasigurive regjionale dhe globale, trashëgimia kristiane mendohet si strumbullar i identitetit nacional. Mirëpo, në kohë normale, gjatë shekujve të fundit, sidomos pas Revolucionit francez borgjez, intenziteti i këtij botëkuptimi është zbehë, duke ardhur në shprehje ndikimi shekullarist.<sup>1</sup>

Në anën tjetër, shtetet perëndimore (evropiane dhe verio-amerikane) në pjesën e dytë të shekullit XX, e sidomos në fillim të shekullit XXI, shfaqin një interesim, e njëkohësisht edhe një shqetësim më të madh lidhur me lëvizjet e njerëzve, e sidomos kur kemi të bëjmë me lëvizjet dhe migrimet e muslimanëve. Disa shkencëtarë këto ndryshime në botën aktuale i konsiderojnë si kërcënim për ndërrimin e strukturës etnike, tradicionale dhe religjioze të shteteve të tyre nacionale. Shtetet që ushqejnë ndjenjën e pastërtisë racore, qytetërore dhe kulturore por edhe të superioritetit religjioz e doktrinar, lëvizjet dhe migrimet e muslimanëve drejt botës evropërëndimore i shohin si shqetësim dhe si kërcënim për shoqërinë perëndimore. Evropërëndimi, sipas tyre, është homogjen, thuajse unikal, i cili do të duhej mbetur e këtyllë përgjithmonë. Evropianët po ashtu, pohojnë, se Evropa është multikulturale, por ne do të shtonim se ky ‘multikulturalitet’ është një “realitet mjaft kompleks”, i cili përbëhet prej simbiozës heleniste, romake, mesjetare-evropiane dhe gjermane me realitetet tjera paraprakisht ekzistuese<sup>2</sup> dhe paraqet në të vërtetë një hapësirë monoreligjioze. Ky është realitet edhe i hapësirave

<sup>1</sup> Jorgen S. Nielsen, Islamsko pravo i njegov značaj za stanje muslimanskih manjina u Evropi, në: Fikret Karcic & Enes Karic, Serijatsko pravo u savremenim drustvima (më tej: J. Nielsen), Sarajevë, 1998, fq. 309.

<sup>2</sup> J. Nielsen, op. cit., fq. 306.

tjera dhe është vështirë të krijojë hapësirë për të huajtë, pos nëse i huaji i pranon të gjitha karakteristikat e vendorëve dhe pastaj ato i përcjellë në brezat vijues.

Shumë perëndimorë, deri në ditët tona, arabët si komb i identifikojnë me Islamin si fe.<sup>3</sup> Pjesa tjetër e perëndimorëve, me arsimim më solid e me më pak paragjykime, vendlindjes islame i shtojnë edhe pjesë të caktuara të Azisë dhe Afrikës. Mirëpo, një pjesë e perëndimorëve refuzojnë ta njohin Islamin si religjion universal por edhe si pjesë të mundshme të Perëndimit. Prandinë muslimane në Perëndim ata e shohin si jorezidencial, të përkohshëm dhe vështirë të adaptueshëm në këtë nënqiell.<sup>4</sup>

### **Takimi dhe bashkëjetesa e Islamit dhe Perëndimit**

**Takimet** e muslimanëve me Perëndimin janë të hershme, qysh në shekullin VII. Pushtimi i pjesëve të konsiderueshme të territoreve bizantine në Azi dhe në Afrikën perëndimore ndikoi që shumë sekte kristiane të hyjnë në përbërje të shtetit musliman, duke pasur një bashkëjetesë dhe bashkëpunim të qëndrueshëm me muslimanët, por, natyrisht, kishte edhe luftra dhe konflikte të ndërsjella. U krijua edhe një literaturë me bollëk polemikash në të dyja anët. Secila palë shpallte fenë e saj si të drejtë.<sup>5</sup>

Në këtë çështje vlen të theksohet se deri sa islami pranoi kristianizmin zanafillor, deri sa islami pranoi Jezusin për të dërguar të Zotit, pala kristiane refuzoi ta njohë islamin për fe burimore e hyjnore.<sup>6</sup>

Përhapja muslimane në drejtim të Evropës u bë nëpërmjet ngushticës së Gjibllartarit për të dalë në Spanjë në vitin 711. Kjo përhapje u ndal në Poatje në vitin 732<sup>7</sup>, kur ushtria muslimane u zbrapsë nga ushtria evropiane. Në anën tjetër osmanlinjtë me shekuj u përpoqën të depërtojnë në Evropë, deri në rrethimin e Vjenës në vitin 1683 dhe zbrapsjen e tyre.<sup>8</sup>

Në pjesën e Spanjës, Portugalisë, Italisë Jugore, nën pushtetin musliman nga shekulli VIII e deri XV, erdhi deri në një zhvillim i hovshëm në kulturë, që ndikoi në paraqitjen e renesansës evropiane. Rënia e Granadës në vitin 1492 ishte edhe fundi i muslimanëve në Evropën perëndimore. Mirëpo, prania muslimane do të vazhdojë në Evropën lindore, respektivisht në Bosnjë, Shqipëri, Kosovë, Serbi, Bullgari, Greqi etj., ku pjesa dërmuese e popullsisë kishte pranuar islamin.<sup>9</sup>

Mirëpo, ndryshimet pas luftës së II botërore, çlirimi i shumë shteteve arabo-muslimane, krizat lokale në vendet muslimane si pasojë e sundimit kolonialist, bënë që prania muslimane në Evropë dhe Amerikën veriore të jetë më i madh dhe të quhet si “prani e re e islamit”. Disa shkencëtarë madje treguan se prania muslimane në Evropën perëndimore është ndryshim i strukturës etnike dhe religjioze dhe se aktualisht

<sup>3</sup> Shih shkrimin tonë në këtë vepër rreth emërimit të kulturës dhe qytetërimit islam.

<sup>4</sup> Yvonne Yazbeck Haddad, Globalizacija islama, në: John L. Esposito, Oksfordska historija islama (më tej: Esposito, OHI), Zenica, 2005/ 1426 h., fq. 573.

<sup>5</sup> Thomas Arnold, Historia e përhapjes së islamit, Prishtinë, 2004.

<sup>6</sup> Adnan Silajdzic, Islam u otkricu krcanske Evrope, Sarajevë, 2003.

<sup>7</sup> Rozhe Garodi, Islami dhe kultura, Sarajevë, 1990/1411 h., fq. 13.

<sup>8</sup> Filip Hiti, Istorija arapa, botimi II, Sarajevë, 1988.

<sup>9</sup> Halil Inalxhik, Perandoria osmane 1300-1600, Gjilan, 2003. Esposito, OHI, op. cit., fq. 574.

paraqesin religjionin e dytë sipas numrit të besimtarëve. Madje, disa shkencëtarë evropianë gjendjen e re në Evropë e cilësojnë si “Evropë të re”.<sup>10</sup>

**Takim i dytë** masovik ndërmjet muslimanëve dhe kristianëve me rëndësi të veçantë janë kryqëzatat dhe inkuizicioni. Synimi kristian që të plaçkisin vendet muslimane dhe ortodokse, por edhe dominimi i Jerusalemit, bënë që bota kristiane ta njollosë veten përjetësisht dhe të identifikohet si popull barbarë dhe jotolerantë.<sup>11</sup> Situata të ngjashme kemi edhe në kohën e inkuizicionit. Me qëllim të deislamizimit, kristianët spanjollë iu ofruan muslimanëve tri obcione:

1) Ta përqafojnë kristianizmin; 2) Të dëbohen nga territoret e Spanjës; 3) Të zhduken.

Sami Frashëri katastrofën e Spanjës e përshkroi “në dy segmente: 1) dëmi material dhe 2) dëmi kulturor (zhdukja e shkencave, njohurive dhe krijimeve islame” ...”u mbytën dijetarët, u rrënuan shkollat, u dogjën librat, çdo njeri filloi të merret me shpatë e luftë”, për të pohuar se “kjo vepra e tyre mbeti turp i madh që do ta përkujtojë historia gjer në Ditën e kijametit.”<sup>12</sup>

Viti 1609 ishte thujtë fundi i muslimanëve në Evropë.<sup>13</sup>

Deri sa në Mesjetë Islami i dha Evropës kontribut të madh në fushën e racionalizmit, shekullarizmit dhe modernitetit të mendimit perëndimor, takimi i radhës dhe prania muslimane në Perëndim është e vonshme, e shkurtër kohësisht dhe fenomen i ri për historinë. Deri sa hebraikëve dhe kristianëve ortodoksë iu është nevojitur disa shekuj për të siguruar vend dhe të drejta në vendet rishtazi të përgjedhura, nuk mund të pritët që muslimanët këtë problem ta zgjidhin për një apo për dy breza.<sup>14</sup>

**Takimi i tretë** masovik ndërmjet muslimanëve dhe kristianëve pason pas rënies së Granadës në vitin 1492, me pushtimin e tokave muslimane nga ana e Perëndimit. Muslimanët me këtë rast shijuan cilësitë ngadhënjimtare, pushtuese, shtypëse dhe imperialiste të Perëndimit. Kjo periudhë zgjati deri në fund të Luftës së II-të botërore dhe ishte nën mëshirën e copëtimit territorial nga ana e Perëndimit. Nga ky copëtim kemi mbi 50 shtete aktuale. Kolonializmi evropian ka lënë gjurmë të thellë në trashëgiminë dhe vetëdijen muslimane dhe është i obsesionuar me luftën kundër muslimanëve, nën ambrellën e “qytetërimit” të muslimanëve. Kjo është quajtur si *el-gazw'uth-thekafi* (imperializmi kulturor), kurse përfshinë burokratët kolonialistë dhe servilët e tyre nga mesi i orientalistëve dhe misionarëve kristianë të kamufluar në shoqata bamirëse e humanitare. Kjo periudhë karakterizohet edhe me dy çështje specifike: forcimi dhe marrja e primatit nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe formimi, forcimi dhe përkrahja e rezervë e shtetit të Izraelit dhe emigrimi dhe popullimi i muslimanëve të Perëndimit dhe në vende të tjera me shumicë kristiane.<sup>15</sup>

<sup>10</sup> Espozito, OHI, op. cit., fq. 574.

<sup>11</sup> Ahmed Shelebij, *Mewsuatut-tarih'il-islamijji we'l-hadaret'ilislamijjeti*, pjesa V, botimi IV, Kairo, 1979, fq. 571 e tutje.

<sup>12</sup> Sami Frashëri, *Përhapja e islamizmit*, Prizren, 1989/1410 h., fq. 11-13.

<sup>13</sup> G & J. Testas, *Inkvizicija*, Zagreb, 1982. Espozito, OHI, op. cit., fq. 575.

<sup>14</sup> Tariq Ramadan, *Biti evropski musliman*, Sarajevë, 2002, fq. 303-304.

<sup>15</sup> Ismail Raxhi Faruki, *Islami dhe cionizmi, në: Islami si provokim global*, Shkup, 2006, fq. 193 e tutje; Espozito, OHI, op. cit., fq. 575-576.

## Bashkësitë muslimane në Perëndim dhe politikat emigruese perëndimore

Reljeji i grupeve islame në Evropë nuk ofron kontura të qarta dhe veçantë të sakta. Aty vërehen tendenca dhe orientime që vështirë identifikohen. Identifikimi evropian i muslimanëve në fundamentalist ose radikal, të cilët nuk duhet besuar dhe të matur, të cilët duhet përkrahur, nuk është i saktë dhe për më tepër krijon konfuzion.<sup>16</sup>

Po ashtu, as numri i muslimanëve në Perëndim nuk është i njohur. Për këtë arsye, nuk kemi shifra të sakta. Statistikat që i hasim nëpër literaturë janë hartuar në bazë të faktorëve dytësorë. Në një statistikë të viteve 1986 në Evropë kishte "23 milionë muslimanë".<sup>17</sup> Vitet që pasojnë sjellin të dhëna të reja të cilat vlerësojnë se vetëm në Perëndim jetojnë rreth 17.4 milionë muslimanë.<sup>18</sup> Mirëpo, këto vlerësime janë të pasakta dhe numri i muslimanëve në Evropë sot është dukshëm më i madh se sa në statistikat e viteve 50-80-të të shekullit XX.

Depërtimi i muslimanëve në Perëndim në qindvjetëshin e fundit është i llojllojshëm, por numri më i madh i muslimanëve në Perëndim ka arritur si pasojë e kolonializmit dhe e luftërave të shumta ku Perëndimi ka qenë aktor i drejtpërdrejtë apo i tërthortë. Kështu, grupacion të konsiderueshëm të muslimanëve gjejmë në Francë, të përbërë nga muslimanët verioafrikanë apo nga ata qendroafrikanë, të ardhur këtu si luftëtarë, punëtorë krahu apo si robër. Këtë grupacion e kanë populluar edhe përkrahësit e kolonizatorëve, të cilët pas çlirimit të vendeve muslimane u larguan bashkë me punëdhënësit e tyre kolonialistë. Pak a shumë është e njëjtë edhe me vendet tjera evropiane, në Gjermani, Angli, Holandë, Belgjikë etj. Këtij procesi i ka ndihmuar edhe mungesa e fuqisë punëtore në Perëndim, e të cilët kanë ardhur për pak para si punëtorë krahu, e të cilët, një pjesë e tyre, me kalimin e kohës arritën ta rregullojnë lejen e qëndrimit dhe të punës. Krizat politike dhe ekonomike në shumë vende muslimane, si pasojë të përzierjes politike të Perëndimit në shume vende muslimane, shumë muslimanë kanë emigruar në Perëndim. Kështu, nga punëtorët me punë të përkohshme, apo nga robërit e dikurshëm muslimanët u bënë qytetarë të Perëndimit.<sup>19</sup> Njohësi i mirë i këtyre problemeve, dr. Tariq Ramadan, pohon se kategoria e këtyre emigrantëve kryesisht kanë qenë të varfër dhe të detyruar për migrim, me nivel të ulët arsimor. Vetëm brezi i dytë e sidomos brezi i tretë ka filluar të ndryshojë gjendjen pozitivisht.<sup>20</sup>

Popullzimit të Perëndimit me muslimanë i kanë ndihmuar edhe krizat dhe luftat në vendet muslimane. Muslimanët gjatë disa dekadave të fundit në kërkim të qetësisë politike dhe të sigurisë fizike dhe arsimimit më të mirë, të kushteve më të mira ekonomike dhe lirisë më të madhe politike janë vendosur në Perëndim. Kemi edhe emigrantë refugjatë dhe disidentë politikë. Vendet ku më së shumti ka muslimanë janë Gjermania, Franca dhe Anglia, e kohëve të fundit Italia dhe Spanja. Secili shtet ka raporte të veçanta ndaj muslimanëve, që varet nga shumë faktorë. Për shembull, në Angli ka më shumë muslimanë nga Pakistani, Bangladeshi dhe India muslimane dhe nga Afrika si ish-koloni të tyre. Në Francë ka më shumë muslimanë nga vendet e Magrebit: Algjeria, Maroku dhe Tunizia. Në Gjermani, Austri dhe Zvicër ka më shumë

<sup>16</sup> Tariq Ramadan, op. cit., fq. 289 e tutje. Shih për tendencat brenda muslimanëve edhe: Nexhat Ibrahim, Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve, Shkup, 1998, fq. 151-163.

<sup>17</sup> Sipas: Espozito, OHI, op. cit., fq. 576.

<sup>18</sup> Shih observimet interesante të autorit Aleksandar del Val, Islamizam i Sjedinjene drzave alijansa protiv Evrope, Beograd, 1998. Krahaso: sipas: Espozito, OHI, op. cit., fq. 576.

<sup>19</sup> Sipas: Espozito, OHI, op. cit., fq. 576-577.

<sup>20</sup> Tariq Ramadan, op. cit., fq. 304.

muslimanë nga Turqia dhe Ballkani. Meqë vendet tjera janë më të vogla nuk do të hyjmë në analiza të veçanta.

Emigrimi i muslimanëve në Amerikë dhe Australi është specifik dhe vetëm dekadave të fundit disi ka filluar të jetë i favorshëm. Në Amerikën veriore kemi muslimanë nga Siria, Libani, Jordani, Palestina, pastaj nga Bangladeshi, India dhe Pakistani e më vonë edhe nga vendet tjera.<sup>21</sup>

Kryesisht, muslimanët në Perëndim kanë lirinë e besimit dhe shfrytëzojnë mënyrat e ndryshme të ndikimit me mjete vetjake. Numri i të konvertuarve është rritur mjaft, sidomos tek femrat. Kështu që tash kemi dy shtresa të muslimanëve: vendorët evropianë dhe amerikanë të konvertuar nga mesi i kristianëve, hebraikëve dhe ateistëve dhe afro-amerikanët, të cilët përbëjnë grupin më të madh të të konvertuarve. Ky grupi i dytë deri vonë është diskriminuar në forma të ndryshme.

\* \* \*

Ekzistojnë tri mënyra apo modele të emigrimeve të evropianëve.

*Mënyra më e pranishme* në Evropë është ajo e gjermanëve, austriakëve dhe zvicëranëve, e cila nuk bën shumë në integrimin e emigrantëve, sepse të gjithë emigrantët i konsideron të përkohshëm, përkundër faktit se fëmijët e emigrantëve lindin e rriten atje, vendlindje e konsiderojnë vendin ku kanë lindur dhe nuk kanë dëshirë të kthehen në vendet e prindërve.

*Modeli i dytë* çështë ai i Frances. Është model asimilues. Nga këta emigrantë kërkohet të heqin dorë nga tradita e deriatëhershme fetare, kulturore dhe politike, me fjalë të tjera, kërkohet të përshtaten në politikën dominuese. Secili musliman në këtë politikë shoqërisht dhe ekonomikisht do të asimilohet.

*Modeli i tretë* është ai i pakicave etnike, çfarë është në Britani, Belgjikë, Luksemburg dhe në disa vende skandinave, në të cilin emigranti ruan identitetin e tij dhe sillet në pajtim me të në mjedisin e ri. Sistemi kanadez i emigracionit është shumë liberal dhe ka frikë se mund të shndërrohet një ditë në një vatër krize të etnive të shumta.<sup>22</sup>

Sistemi amerikan i emigracionit është, siç e quajnë disa, *sistem asimilues, shkrirës*. Sipas fundamentalistëve kristianë Amerika është vend i vlerave judeo-kristiane. Me këtë veprim ata mohojnë dy parime të botës perëndimore:

- Mosndarjen e fesë prej shtetit dhe
- Injorimin e feve tjera si islami, budizmi etj.

Kemi edhe *modele të tjera*, sikurse është modeli i shoqërisë pluraliste, ku do të vinin në shprehje shumë identitete, shumë vlera: fetare, nacionale, kultrurore etj. Mirëpo, të parët frikësohen se kjo trajtë do ta humbë forcën kohezive amerikane dhe identitetin autentik amerikan (nëse një identitet i këtillë ekziston).

Por, këto forma ndryshojnë nga dita në ditë. Shtetet e ndryshme hartojnë strategji nga rasti në rast, duke kufizuar dhe kontrolluar migracionin. Thuajse të gjitha shtetet kanë

---

<sup>21</sup> Sipas: Espozito, OHI, op. cit., fq. 578-580.

<sup>22</sup> Shih: Tariq Ramadan, op. cit., fq. 304.

marrë masa konkrete për kufizimin e migrimieëve të muslimanëve, siç ka bërë Anglia në vitin 1962 dhe 1976 apo SHBA-të në vazhdimësi etj.<sup>23</sup>

### Muslimanët dhe sfida e jetesës në Perëndim

Migrimi i muslimanëve në vendet nacionale evropiane i gjeti perëndimorët me vetëdije të formuar nacionale. Dyqind vitet e fundit, nëpërmjet sistemit shkollor por edhe nëpërmjet formave tjera, qytetari evropianë është përgatitur si për perceptim ashtu edhe për interpretim të historisë së tij nacionale. Kanë kaluar disa breze me vetëdijen e ngulitur në kokë e zemër se kultura e tyre është *superiore* kundrejt kulturave të tjera, kurse e cila bazohet në vlerat e përgjithshme evropiane dhe vetjake nacionale.

Edhe emigrantët në vendet e tyre formojnë një identitet të caktuar, varësisht nga vendi dhe mjedisi ku janë rritur e zhvilluar. Varësisht nga ky formim prej nga vjen emigranti do të jetë edhe perceptimi dhe përgjigjja e emigrantit për vendin ku jeton dhe për pozitën e tij në atë vend. Emigrantët pak a shumë kanë një vetëdije se çfarë vendi është ai ku shkon ky në bazë të përvojës së formuar nga e kaluara. Kështu, muslimanët të cilët institucionin e familjes e kanë të shenjtë nuk pranojnë sistemin e jetës evropiane: paramartesën apo jashtëmartesën, degjenerimin moral, perversitetin dhe ligësi të tjera. El-Mewdudi i ballafaquar me këtë pyetje dhe me këtë problem preferon ikje nga ato vende me qëllim të ruajtjes së pastërtisë së shpirtit dhe trupit. Mirëpo, disa intelektualë të tjerë preferojnë se muslimanët duhet ballafaquar me problemet për të përhapur besimin islam në vende të reja. Disa të tjerë i shtojnë këtij faktori edhe çështjen tjetër, se me praninë tonë në vendet jomuslimane jo vetëm që përhapim fenë islame por edhe shpëtojmë jomuslimanët nga jeta e tyre e shtrembëruar në besim, moral, politikë, ekonomi etj. Mirëpo, për këtë qëllim duhet përgatitur edhe elemente tjera mbrojtëse sikurse: duhet inkuadruar edhe elementin etnik, gjuhësor dhe racor, por edhe të tjera, që në vendin e caktuar mund të ndryshojnë në nuanca më të vogla. Duhet pasur parasysh se disa gjera janë të vështira dhe kërkojnë sakrificë. As liberalizmi i tepruar dhe as getoizimi i tepruar nga ana e muslimanëve nuk do të japin rezultate.<sup>24</sup> Mirëpo, ritualet e përditshme fetare, agjërimi, kurhani, kujdesi që menyja e tyre e përditshme të mos ketë ushqime të ndaluara, veshmbathja islame, mjekra të meshkujt, paraqesin ca kufizime kundrejt mjedisit fetarisht dhe kulturalisht tjetërfare, dhe masë e kriter për t'u mbrojtur nga ndikimet e huaja të dëmshme. Prandaj, për disa muslimanë ritualet janë islam por edhe islami është ritual. Brezi i dytë i emigrantëve muslimanë në Evropë, i lindur dhe rritur atje, imponon dhe kërkon nga dijetarët të rimëkëmbin mendimin islam në Evropë dhe të ofrojnë "suazat referente teologjike dhe juridike që janë më të qartë dhe më mirë të përshtatura kontekstit evropian".<sup>25</sup> Pas shumë bisedave dhe konsultimeve, dijetarët shtruan pesë parime bazore:

1) Muslimani, qoftë rezident apo qytetar, duhet ta shoh veten si palë e cila është e lidhur në kontratë, shoqëror dhe moral, të lidhur me vendin në të cilin jeton, dhe duhet respektuar ligjet e atij vendi;

<sup>23</sup> Sipas: Espozito, OHI, op. cit., fq. 582.

SHBA-të gjatë marsit 2006 sollën një ligj për kufizimin e migracionit, që solli deri te shumë debate në Senatim amerikan por edhe te përfaqësuesit e emigrantëve dhe shoqatave për mbrojtjen e të drejtave të huajëve në SHBA, duke e konsideruar këtë ligj si antihuman.

<sup>24</sup> Sipas: Espozito, OHI, op. cit., fq. 585-586.

<sup>25</sup> Tariq Ramadan, op. cit., fq. 306.

2) Legjislacioni evropian (i cili është shekullar sipas natyrës) i lejon muslimanëve ta praktikojnë në masën më të vogël bazat e religjionit të tyre;

3) Koncepti i vjetër *dar'ul-harb* (i cili nuk është nxjerr nga Kur'ani as që është pjesë e traditës pejgamberike) konsiderohet i vjetëruar; janë sugjeruar koncepte të tjera si mënyrë e shikimit pozitiv në praninë muslimane në Evropë;

4) Muslimanët duhet ta shohin veten si qytetarë në kuptim të plotë, dhe duhet të bashkëpjesëmarrin (duke kërkuar në të njëjtën kohë respektimin e vlerave të tyre vetjake) në jetën shoqërore, organizative, ekonomike dhe politike të vendeve në të cilat jetojnë;

5) Në legjislacionin evropian të marrë në tërësi nuk ka asgjë që i pengon muslimanët, ose cilët do qytetarë të tjerë, të sjellin vendime në pajtim me religjionin e tyre.<sup>26</sup>

### **Jeta e muslimanëve në Perëndim - model i kulturës së xhamisë**

Punëtorët e përkohshëm muslimanë në Perëndim, të cilët ende janë të lidhur me vendlindjen nga kanë ardhur dhe në të cilën do të ktheheshin posa të tubojnë para të mjaftueshme për t'u kthyer, kanë treguar shumë pak interesim për themelimin e institucioneve islame në vend të huaj. Por, ata që kanë vendosur të mbeten në Perëndim kanë vendosur të ndërtojnë institucione fetare sikurse është xhamia. Problemi i mjeteve materiale ishte i pranishëm, por edhe lejet ishin kaptinë në vete. Megjithatë, xhamitë e para i kanë ndërtuar për nevojat e diplomatëve të shteteve arabo-islame apo me ndihmën e tyre. Këto institucione thuajse në të gjitha rastet nga Perëndimi janë shikuar si armiqësore, e më së lehti si të dyshimta. Në fund të fundit, gjendja e tyre drejtpërdrejt varej nga rrethanat aktuale politike e ekonomike ndërmjet vendeve islame dhe perëndimore, që mund të bindemi sidomos pas 11 shtatorit 2001 e këndej.

Në Perëndim nuk ekziston formë se si duhet ndërtuar xhami. Secili shtet vepron tjetërfare. Për këtë arsye, muslimanët duhet të organizohen varësisht nga shteti ku jetojnë dhe varësisht nga mundësitë që lejon legjislacioni i shtetit të caktuar. Evropës i përshtatet që bashkësitë muslimane të formohen në forma më të organizuara e demokratike. Por, kjo është shenjë e komunikimit më meritore por njëkohësisht edhe e kontrollimit më të lehtë të organizatave fetare të posaformuara. Kjo i përshtatet edhe disa vendeve islame të cilat s'kanë dëshirë që nga Evropa punëtorët e tyre të kthehen si fundamentalistë.<sup>27</sup>

Në Amerikën veriore u ndërtuan disa dhjetëra xhami në vitet e 50-ta të shekullit XX. Sot ky numër është në disa qindra. Normalisht, shumica e muslimanëve në vendet e reja kanë bartur ide të caktuara nga vendet e tyre, si egjiptianët nga Vëllezërit muslimanë, pakistanzët nga Xhemat-i islam etj. Ndërtimin e më shumë xhamive e kushtëzoi numri i madh i muslimanëve në Perëndim. Mirëpo, kjo rezultoi me nevojën tjetër. Shumë xhami kanë nevojë për koordinim punësh, aksionesh e idesh, dhe lindi nevoja për formimin e bashkësive islame, kryesisht nga shtetet që vinin. Fjala vjen, besimtarët turqë formonin bashkësinë islame turke, ata boshnjakë bashkësinë islame boshnjake dhe ata shqiptarë

<sup>26</sup> Tariq Ramadan, op. cit., fq. 307.

<sup>27</sup> Tariq Ramadan, op. cit., fq. 308.

bashkësinë islame shqiptare. Këto xhami dhe bashkësi janë ndihmuar me mjetet vetjake por edhe me ndihmën e shteteve si Arabia, Kuvajti, Libia, Emiratet, Turqia etj.. Herëherë me sasi simbolike kanë ndihmuar edhe vetë shtetet perëndimore si Holanda, Suedia, Norvegjia etj. Mendohet se në Gjermani ka mbi 2000 xhami, mesxhide, faltore apo qendra islame, në SHBA ka mbi 1500 sosh, në Francë mbi 1000, në Angli 600, në Zvicërr mbi 200 etj..<sup>28</sup>

Numri i rritur të muslimanëve në Perëndim nuk është pasojë e konvertimit të madh të vendorëve, por ka qenë rezultat i bashkimit të emigrantëve me familjet e tyre, por edhe i krizave të ndryshme në Lindjen e afërt, të mesme dhe të largët: Libani, Palestina, Kashmiri, Somalia, dhe i luftërave të kohëve të fundit, nga Çeçenia, Bosnja, Kosova, Iraku, Afganistani etj. Ky migrim, i pakontrolluar dhe me nivel të ulët arsimor të emigrantëve, solli edhe ndarje të reja sektare dhe doktrinare muslimane (brenda spektrit sunit, shi'it dhe sufist dhe të atyre me kolorit islam por antiislam si ahmeditët-kadijanitët, behaitët-babitët etj.). Këto xhami apo faltore nuk shërbenin vetëm për kryerjen e namazeve ditore, por shërbenin edhe për mësim të fesë së tyre, për solidarizim me rastet e ndryshme me bashkëvendësit apo edhe me bashkëfetarët e tyre. Xhamia në Perëndim është qendër e konfirmimit dhe përhapjes së vlerave të përbashkëta shoqërore dhe kulturore; ajo është bërë simboli kulminant jo vetëm i pranisë së islamit në Perëndim por edhe i vazhdimit të jetës së islamit atje. Bindja e shumicës së udhëheqësve fetarë në Perëndim është se islami është ilaç, terapium për sëmundjet që i ka Perëndimi.

### Zhvillimi organizativ dhe arsimimi islam

Formimi dhe zhvillimi i organizatave kulmore, të pavarura nga shtetet nga vijnë, është i vonshëm. Kjo i shkon për shtati edhe shteteve perëndimore, të cilat kanë dëshirë të komunikojnë me organizata mirë të organizuara. Kështu, ka ardhur deri te formimi i *Bashkësisë Islame të Amerikës Veriore* (Islamic Society of North America – ISNA). Për të pasur primat mbi bashkësitë, shumë shtete kanë provuar të ndikojnë në këto organizata. Për këtë qëllim, Arabia Saudite ka formuar *Zyren Evropiane të Ligës Botërore Muslimane në Brisel* dhe dy zyra në Nju Jork dhe Toronto, me ftesë që xhamitë të anëtarësohen në Këshillin e Xhamive në Evropë. Aktive janë edhe Turqia, Maroku etj..<sup>29</sup> Përkundër tentimeve, këto organizata kulmore nuk patën sukses. Disa aleanca grupesh e fondacionesh humbën ndikimin për shkak të mungesës së mjeteve, të kuadrove përkatëse apo përçarjeve ndërmjet grupeve rivale.

Në anën tjetër, brenga kryesore e muslimanëve në Perëndim është që fëmijëve të tyre t'u sigurojnë arsimim dhe edukim islam. Ky ishte problemi qendror i shtendosjes. Bashkësitë migruese shpesh janë të vetëdijsëm para problemit se këta presin që shkollat t'ua përmbushin ambiciet që i kanë kundrejt fëmijëve të tyre, por edhe frikën se ç'do të bëjë shkolla që fëmijët e tyre t'i largojë nga prindërit e tyre, nga kultura e tyre dhe nga religjioni i tyre.<sup>30</sup> Mirëpo, atje ku nuk kishte mundësi, muslimanët i regjistronin fëmijët e tyre nëpër shkolla shtetërore publike apo fetare kristiane. Prindërit muslimanë

<sup>28</sup> Sipas: Espozito, OHI, op. cit., fq. 590. Këto shifra duhet kuptuar si të vjetëruara. Shifrat aktuale janë më të mëdha.

<sup>29</sup> Sipas: Espozito, OHI, op. cit., fq. 593.

<sup>30</sup> J. Nielsen, op. cit., fq. 308.



shpesh kishin vërejtje në ndërhyrjen e arsimtarëve në atë që quhet e paprekshme, sepse është në kundërshtim me mësimet islame. Muslimanët kishin vërejtje edhe në klasët e përzierra djemë-vajza, në lëndën e edukatës seksuale që mësohej nëpër shkolla dhe në këshillat e zyrtarëve të shkollave që janë në kundërshtim me vlerat e përgjithshme dhe sidomos ato zyrtare.

Për këtë arsye, vendi më i sigurtë i arsimimit dhe i edukimit islam mbetet pa dyshim shtëpia prindërore, por edhe shumë seksione, takime apo forma të ndryshme të organizimeve në kuadër të xhamive dhe të qendrave islame në ato vende. Viteve të fundit, disa dhjetëra shkolla islame të nivelit fillor kanë marrë liçencën brenda SHBA-ve. Këto shkolla aplikojnë programin amerikan, por edhe plotësimin me përmbajtje islame dhe me mësimin e gjuhës arabe.<sup>31</sup>

Edhe në Angli kishte probleme të caktuara. Pasi që feja nuk ishte e ndarë nga shteti, dita shkollore ishte e detyrueshme të fillojë me lutje fetare. Feve të tjera iu lejohej mospjesëmarrja në këto tubime. Mirëpo, me ligjin e vitit 1988 kjo e drejtë iu mohua muslimanëve. Po ashtu, deri sa në Angli ndihmohet bashkësia hebraike dhe katolike, muslimanët nuk ndihmohen. Shkolla e parë shtetërore muslimane në Angli është hapur më 1998 në Londër e tjetra në Birmingem.<sup>32</sup> Vetëm në disa shkolla në Angli janë krijuar kushte të caktuara edhe për fëmijët muslimanë, sikurse veshja e vajzave, ora e notit dhe e edukatës fizike të bëhet ndarazi për djemë e vajza etj..<sup>33</sup>

Në Holandë pozita e arsimimit islam është jo e favorshme. Ndonëse kristianët dhe hebraikët mësojnë fenë e tyre pa probleme dhe gëzojnë ndihmë materiale të shtetit, muslimanëve kjo nuk iu është mundësuar. Pas shumë kërkesave edhe muslimanëve iu është lejuar mësimi i fesë islame, por me kusht që gjatë mësimit të flitet në gjuhën holandishte, që ishte pengesë për shumë imamë, sepse nuk e njihnin sa duhet apo nuk e njihnin fare gjuhën e vendit. Në disa qytete më 1988 janë hapur shkolla islame, që në vitin 1992 ky numër të arrijë në rreth 20 shkolla islame.<sup>34</sup>

Në Gjermani gjendja është e larmishme. Në disa krahina është lejuar që në disa shkolla të mësohet edhe mësimi islam, me kufizime dhe rregulla të veçanta. Mënyra e arsimimit rregullohet sipas federatave të caktuara, por ende nuk ekziston një mënyrë unike dhe mirëkuptim i plotë ndaj muslimanëve.<sup>35</sup>

Arsimimi islam nëpër burgje dallon nga vendi në vend. Në SHBA shteti angazhon imamë që të arsimojnë të burgosurit, të kurorëzojnë besimtarët dhe të kryejnë shërbimet e pasvdekjes, pastaj të vizitojnë spitalet, burgjet dhe ushtrinë.

Ka edhe probleme. Krahas problemeve të tjera, problem me rëndësi është se shumë imamë nuk kanë arritur të akomodohen në shtetet e reja dhe shpesh paraqesin idetë e vendeve nga kanë ardhur, që ka ndikuar në antipati të shteteve përkatëse dhe pengesa normalisht.

---

<sup>31</sup> Espozito, OHI, op. cit., fq. 594.

<sup>32</sup> Espozito, OHI, op. cit., fq. 595.

<sup>33</sup> J. Nielsen, op. cit., fq. 315.

<sup>34</sup> Espozito, OHI, op. cit., fq. 596. J. Nielsen, op. cit., fq. 319-320.

<sup>35</sup> J. Nielsen, op. cit., fq. 317-319.

## Marrëdhëniet ndërfitare: Islamofobia dhe ksenofobia

Mendimi se për të krijuar kushte për dialog dhe aktivitet ndërfitar në Perëndim përpjekje kanë bërë vetëm kristianët dhe hebraikët, kurse muslimanët këto nisma i kanë pritur me rezerva e neglizhim nuk qëndron. Disa organizata me rëndësi në Perëndim, sikur *Konferenca e Kishave Botërore* dhe *Këshilli i Konferencave Episkopale në Evropë* kanë përkrahur projektin e përbashkët për islamin në Evropë. Edhe *Këshilli i Kishave Botërore në Gjenevë* ka hapur zyren për raportet ndërfitare dhe ky asociacion përdorë me vite të tëra shërbimet e dijetarëve muslimanë. Në SHBA gjendja është diç më e vështirë. Këtu deri vonë nuk ka ndonjë debat apo dialog.

Muslimanët janë të vetëdijshëm për nismat nga Perëndimi, por këto nisma ende janë të pasinqerta dhe diskredituese. Vatikanin dhe shtetet tjera perëndimore ndryshe sillen ndaj hebraikëve e ndryshe ndaj muslimanëve. Kjo shihet edhe nga rasti i Papa Gjon Palit të II-të, i cili në një deklaratë kërkoi falje në emër të Kishës Katolike për dhunën e ushtruar kundër hebrenjve<sup>36</sup>, por këtë nuk e bëri edhe kundrejt muslimanëve. Për shkak të qëndrimit jo të barabartë, për shkak të standardeve të ndryshme, muslimanët nuk pranojnë dosido të hyjnë në dialog, dialogut të cilit i paraprinë paragjykimi, nënçmimi dhe mosnjohja. Por, as propaganda dhe angazhimi i disa intelektualëve muslimanë nëpër Perëndim, duke zhvlerësuar kristianizmin dhe judaizmin para syve të perëndimorëve, nuk do të jepë rezultate të suksesshme. Përkundrazi, kjo metodë ka kundërefekte, zgjon emocione, rritë moskuptimet dhe prekë unin e kundërshtarëve. Në disponimin anti-dialog ndikojnë edhe shumë faktorë, por si më kryesor janë edhe:

- Skepsa e judaistëve nëse dialogojnë muslimanët dhe kristianët, duke e parë veten të anashkaluar;
- Paragjykimet evangjeliste ndaj muslimanëve, në sytë e të cilëve muslimanët duken si të dërguar të antikrishtit.
- Paragjykimet e disa muslimanëve se dialogu me jomuslimanët është baraz me kufër (mosbesim), prandaj duhet shmangur pa tjetër bisedimeve.
- Izraeli pranon vetëm ato biseda të cilat janë në shërbim të cionizmit dhe Izraelit të madh.

Në Suedi tentimi për dialog ka pasur sukses më shumë se në vendet tjera. Organizimi ka qenë më i mirë, më dinjitoz dhe sukseset kanë qenë më të mira. Edhe këtu, grupimi i Vëllezërve muslimanë është për dialog, kurse ai vehabist është negativ, për mosdialog.<sup>37</sup>

\*\*\*

Diskutimet ndërmjet perëndimorëve dhe muslimanëve janë të gjalla, të ashpra, përplotë insinuata dhe të llojllojshme, por aktualisht dy tema janë të pashmangshme: *siguria* dhe *pajtimi kulturor*. Deri sa deri tash në Perëndim flitej kryesisht për muslimanë me qëndrim të përkohshëm, kohëve të fundit evropianët shqetësohen nga dëshira dhe këmbëngulja e muslimanëve që në Perëndim të vendosen përgjithmonë. Ky shqetësim është rezultat i

<sup>36</sup> Milazim Krasniqi, Dhuna dhe qytetërimi perëndimor /Islami si fillim i historisë/, Shkup, 2006, fq. 79.

<sup>37</sup> Espozito, OHI, op. cit., fq. 599-600.

paragjytimeve të vjetra që janë bartur nga shekulli në shekull, nga brezi në brez, duke iu falenderuar komentuesve fanatikë kristianë por edhe sjelljeve të individëve dhe grupeve të vogla të muslimanëve.

Sidomos indikativ është Revolucioni islam në Iran më 1979, i cili tërhoqi vërejtjen dhe zgjoi vëmendjen e jomuslimanëve për islamin si kërcënim potencial. Ndonëse i befaso, ky revolucion e gjeti vendin e tij në Perëndim, në vargun e bindjen negative për islamin nga fillimi e deri në ditët aktuale. Edhe qëndrimet dhe veprimet represive të ndërsjella muslimano-perëndimore ndihmuan dhe ndikuan në rritjen e armiqësisë ndërmjet veti. Veprimet e muslimanëve, kryesisht si përgjigje ndaj dhunës perëndimore dhe si përgjigje ndaj përkrahjes së drejtpërdrejtë të SHBA-ve por edhe Evropës ndaj Izraelit, shtuan frikën e perëndimorëve prej fundamentalizmit muslimanë. Mediumet elektronike dhe të shkruara perëndimore shkruanin për muslimanët se janë antiliberal, të prapambetur dhe antiintelektual. Reagimi i rreptë i mëhershëm muslimanë kundrejt botimit të librit blasfemues të Selman Rushdiut në fund të shekullit XX, sikurse edhe reagimi kryesisht i dhunshëm muslimanë kundër karikaturave antiislame më 2005 dhe 2006 në Danimarkë, Francë, Gjermani etj., vetëm sa e forcuan bindjen e perëndimorëve për natyrën antitolerante dhe antiqytetëruese të fesë islame.<sup>38</sup>

Këto bindje të tyre bënë që në vitin 1985 në San Fransisko, Orange County në Kaliforni, Denver, Quincy, Dearborn, Hjuston, të digjen, të vëhen bomba në disa xhami apo qendra islame. SHBA-të edhe pse hartuan ligjin për krimet nga urrejtja, kurrë ky ligj nuk u aplikua për mbrojtjen e muslimanëve dhe të objekteve të tyre.<sup>39</sup>

Në Francë, për shkak të qëndrimit inferior ndaj muslimanëve, punëtorët muslimanë nuk arrijnë të integrohen edhe pas punës shumëvjeçare atje. Ata shihen me sy të këqinj, si fajtorë për çdo dështim të politikës franceze. Sipas të gjitha analizave, problemi i mosintegritimit të punëtorëve muslimanë në Francë qëndron në faktin e prejardhjes së tyre afrikane dhe besimit të tyre musliman. Mendoj se mendimet e Zhan Pol Sartrit, Ali Sheriatit, Rozhe Garodit lidhur me këtë problem janë mjaft sqarues.<sup>40</sup>

Diskutimi publik se si të veprohet me muslimanët në Evropë, pasi ata, sipas tyre, paraqesin rrezik për sigurinë e njerëzve dhe dhuna ndaj muslimanëve duke i vrarë, djegur apo arrestuar nën pretekst të terrorizimit, kanë sjellë në një gjendje shqetësuese dhe kanë lënë gjurma trishtuese në mendjen e muslimanëve. Ata veten e shohin si viktimë të shoviznimit dhe ksenofosibë ndaj muslimanëve.

## **Dallimet kulturore dhe njohja e aplikimit të së drejtës islame**

Pas rënies së komunizmit në vitet e 90-ta, Perëndimi disi u gjetë i vetmuar, pa rival me të cilin do të garonte dhe pa pretekst me të cilin do ta mobilizonte popullin e vet. Fillimisht paqëndruesit besonin se më në fund do të dominojë paqja botërore, sepse Perëndimi evropian e munda lindjen evropiane.<sup>41</sup> Mirëpo, pa vonuar, qendrat studiuuese

---

<sup>38</sup> Kërkesa e muslimanëve në Angli që të aplikohet ligji mbi blasfeminë dhe së paku të ndalohet distribuimi i librit të Selman Rushdiut solli në dijeninë se ky ligj nuk vlen për islamin, por vetëm për fenë shtetërore, atë anglikane. Shih: Espozito, OHI, op. cit., fq. 602.

<sup>39</sup> Espozito, OHI, op. cit., fq. 602.

<sup>40</sup> Hisham Xhait, Evropa dhe Islami, Shkup, 2004; Rozhe Garodi, Slucaj Izrael, Zenica, 1998.

<sup>41</sup> Mahatir Muhamed, Një marrëveshje e re për Azinë, Shkup, 2004, fq. 184.

dhe kërkimore-hulumtuese në SHBA, me B. Lewisin, S. Huntingtonin, F. Fukujamën e të tjerë, dhe qendrat evropiane, të motivuar nga militantizmi kongjenital<sup>42</sup>, nxituan që për armik të ri të identifikohet islami dhe muslimanët. Islami dhe muslimanët u paraqitën si gjakpirës, shkatërrues dhe me prirje për shkatërrimin e Perëndimit. Tekstet e S. Huntingtonit dhe të ngjashmëve si ai, i pëlqyen politikanëve perëndimorë, që ndikoi te muslimanët ta kuptojnë se periudha e kolonializmit nuk ka kaluar, por vetëm ka ndryshuar metoda, folklori dhe formalitetet tjera. Thelbi është i njëjtë. Vetëm Perëndimi posedon vlera të mirëfillta dhe vetëm ai mund të udhëheq me botën. Qytetërimet dhe fetë tjera nuk janë të drejta dhe paraqesin regres në historinë e mendimit njerëzor. Të kërcënuar nga këto ide çoroditëse, muslimanët kanë rezistuar si bedem i fundit në mbrojtjen e dinjitetit dhe identitetit musliman. Para syve të muslimanëve, mbrojtja nga invadimi perëndimor nuk është vetëm krenari nga e kaluara por edhe mbrojtje për të ardhmen.<sup>43</sup>

\*\*\*

Një pjesë e liderëve muslimanë në Perëndim kanë dëshirë që shtetet perëndimore ta pranojnë të drejtën islame si pjesë të ligdhënies shtetërore. Kjo dëshirohet për arsye që edhe muslimanët të trajtohen sikur pjesëtarët e feve të tjera. Shumë muslimanë, pra edhe nga tokat shqiptare, nga frika se do të varrosen në varrezat jomuslimane, kufomat e të afërmeve i kanë dërguar në vendlindje. Mirëpo, duke i formuar varrezat muslimane, muslimanët nga SHBA-të, Kanadaja e vende të tjera rrallë herë i dërgojmë të vdekurit e tyre në vendlindje, pos rasteve emocionale. Disa xhami në Perëndim madje kanë edhe vende të veçanta për përgatitje të të vdekurve. Pas vitit 1984 në Angli muslimanëve u janë bërë ca lëshime përkitazi me të drejtën individuale (kurorëzime, shkurorëzime, kujdestaria ndaj fëmijëve, trashëgimia etj.). Edhe në SHBA dhe Kanada gjykatat pranojnë kurorëzimet dhe shkurorëzimet islame si dokument të vlefshëm ligjor.<sup>44</sup>

Ushqimi hallall disi po zë vend në vendet perëndimore. Perëndimorët kanë filluar të miratojnë disa dispozita islame, sikur thertoret muslimane, restorantet ku servohet veçantë ushqimi muslimanë me ushqim dhe enë të veçanta.

Mirëpo, kjo situatë, ky ndërrim i ri, ka filluar të zgjojë pakënaqësi, revoltë në mesin e banorëve vendorë. Perëndimin sidomos e iriton çështja e femrës dhe reportazhat televizive për kinse shkeljet e të drejtave të femrës, si mos/vënia e shamisë, jeta paramartesore e femrës në islam, e drejta e shkurorëzimit sikurse në Perëndim. Në anën tjetër, muslimanët këtë shqetësim të perëndimorëve e marrin si cenim të të drejtave elementare fetare dhe njerëzore.<sup>45</sup> Herë-herë këto probleme eskalojnë në probleme të mirëfillta. Problemet janë të shumta kurse intenziteti i mos/aplikimit të tyre varet nga vendi në vend dhe nga koha në kohë.

---

<sup>42</sup> Mahatir Muhamedi evropianët i quan të "luftëdashës dhe të pangopur. Paqja për ta është anateme. Atyre medoemos u duhet të kenë luftë. Për të pasur luftë ata duhet të gjenë armiq." Sipas: Mahatir Muhamed, op. cit., fq. 184. Krhs.: Alija Izetbegovic, Islam izmedju Istoka i Zapada, Beograd, 1988, fq. 251.

<sup>43</sup> Espozito, OHI, op. cit., fq. 604.

<sup>44</sup> Espozito, OHI, op. cit., fq. 605-606.

<sup>45</sup> J. Nielsen, op. cit., fq. 308.

Si faktorë dallimesh në mes muslimanëve dhe vendorëve perëndimorë kemi shkallën e zhvillimit dhe të standardit jetësor, politikën banimore, shërbimet shoqërore, traditat e ndryshme, gjuhën si pengesë e afrimit, arsimimin, shtetësinë etj.<sup>46</sup>

### **Prania e muslimanëve në Perëndim - sfidë për Perëndimin**

Përkundër numrit gjithnjë e më të madh të muslimanëve në Perëndim, megjithatë fuqia e tyre është ende e vogël që të ndikojnë pozitivisht dhe konstruktivisht në qeveritë perëndimore, në mediat e shkruara dhe elektronike dhe në elitën e tyre intelektuale dhe kulturore. Ka shumë faktorë për këtë pafuqi dhe pamudnësi, por më të theksueshëm janë: mungesa e përvojës së muslimanëve në aktivitetin politik, frika nga aktiviteti politik, mungesa e liderëve me përvojë dhe efikas për koalicione politike për ndërrime në legjislacion etj. Por, edhe mosdëshira, islamofobia dhe ksenofobia e perëndimorëve për bashkëpunim, dhe droja nga reagimi i lobit çifut, është një pengesë e theksuar.<sup>47</sup>

Bashkësia Islame në Perëndim është para dilemës: të merrë pjesë në zgjedhje për shoqërinë jomuslimane dhe deputetët që mbrojnë interesa të kundërta?

Deri sa brezi i parë i emigrantëve ishte i rezervuar dhe skeptik ndaj pjesëmarrjes në politikë, brezat vijues gjithnjë e më shumë po marrin pjesë në aktivitetet politike. Sidomos janë aktivë në nivelin lokal, sepse pikërisht aty trajtohen shumica e çështjeve të rëndësishme për jetën e qytetarëve: sigurimi social, sigurimi shëndetësor, çështja e banimit, shërbimet komunale, zhvillimi ekonomik dhe qytetëror, trajtimi i barabartë, koha e lirë etj. Këto trajtohen ndryshe nga vendi në vend. Janë formuar disa trupa të cilët kishin për detyrë të njoftonin segmentet qeveritare për nevojat e emigracionit muslimanë, të demantojnë të pavërtetat kundër tyre, të prezantojnë nevojat dhe synimet e tyre para opinionit, sikurse: *Shoqata Nacionale e Amerikanëve me Prejardhje Arabe* (National Association of Arab Americans) e formuar më 1972, *Komiteti Antidiskriminues i Amerikanëve me Prejardhje Arabe* (The American-Arab Anti-Discrimination Committee) i formuar më 1980, etj. Këto dhe institucione të tjera nuk mbronin vetëm interesat e ngushta të tyre, por edhe problemet e muslimanëve në botë, sikurse janë: pozita e muslimanëve në Qipro, Xhamu dhe Kashmir, Bosnje, Kosovë, Bullgari, Filipine, Kinë, Çeçeni, Palestinë, Greqi etj. Këta organizma i njeh edhe Shtëpia e Bardhë.<sup>48</sup>

Mirëpo, tërë kjo është shumë pak krahasuar me atë sa duhet të bëhet për një zhvillim normal politik, ekonomik e kulturor. Duhet theksuar se angazhimi i muslimanëve është tejet i vogël, por edhe dëshira e shteteve perëndimore për t'i zgjidhur problemet e qytetarëve muslimanë në vendet e tyre nuk ekziston.

\* \* \*

<sup>46</sup> J. Nielsen, op. cit., fq. 308-309.

<sup>47</sup> Espozito, OHI, op. cit., fq. 607.

<sup>48</sup> Espozito, OHI, op. cit., fq. 607-609.

Prania e muslimanëve në Perëndim shtron një sërë çështjet e problemesh të cilat muslimanët por edhe vendet nikoqire duhet zgjidhur në të ardhmen.

Disa dijetarë perëndimorë mendojnë se muslimanët duhet integruar në shoqërinë perëndimore dhe se Perëndimi do të fitojë me llojlojshmërinë e kulturave e qytetërimeve të ndryshme. Mirëpo, ka edhe dijetarë të tillë që shprehin drojë nga prania e muslimanëve në Perëndim, janë ksenofobikë, duke theksuar se do të prishet identiteti unikal evropian.<sup>49</sup> Këtë çështje kryeministri aktual italian dhe antiislamisti i përbetuar Silvio Berlusconi ka pohuar se *“Ne nuk dëshirojmë që Italia të bëhet vend multietnik dhe multikulturor. Të huajtë që janë këtu, duhet t’ia përshtasin veten ligjeve tona dhe rrugës tonë jetësore.”* Kurse në propozimin e partisë komuniste që Islami të mësohet në shkolla për aq kohë sa edhe kristianizmi, S. Berlusconi pohon se *“Ai (Islami) është material që më bën mua të rrënoqthem”*.<sup>50</sup>

Vetë muslimanët presin që Perëndimi ta njohë identitetin islam të muslimanëve dhe të trajtohet barabartë me fetë, kulturat dhe qytetërimet tjera, sepse muslimanët tashmë janë subjekt i rëndësishëm edhe në sasi edhe në cilësi. Çdo vonesë, është e qartë, do të ndikojë negativisht dhe do të lë hapësirë të devijojë kah skajshmëritë.

### Si të ecët përpara – perspektiva e problemit?

Është folur dhe është shkruar për shoqërinë pluraliste evropiane, me gjithë mëdyshjet që nënkupton kjo shprehje, që erdhi si rezultat i migrimeve pas vitit 1945 e këndeje. Mirëpo, duhet vërejtur se ky ‘pluralizëm’ shoqëror, fetar dhe kulturor është i lokalizuar në qytete industriale dhe qytete më të mëdha të diplomacisë. Pluralizmi shoqëror, fetar dhe kulturor nënkupton edhe mënyrat e ndryshme të të menduarit dhe të veprimit, që sërish nënkupton krijimin e hapësirës për diversitetet e pranishme fetare, kulturore dhe nacionale. Drejtësia duhet t’i ketë disa fytyra, varësisht nga përcaktimi fetar dhe kulturor. Në tërë këtë duhet pasur parasysh edhe rrezikun nga roli dezintegrues i këtyre diversiteteve, nëse problemet nuk trajtohen cilësisht dhe konstruktivisht; miratimi vullnetar i dallimeve pozitive dhe nënshtrimi i tyre ndaj respektit të ndërsjellë, eliminimi i privilegjeve nga e kaluara dhe braktisja e barrës së paragjyqimeve janë vetëm disa faktorë drejt paqës. Vetë Kisha perëndimore por edhe Bashkësia Muslimane mund të luajë rol crucial në tërë këtë, duke mos dalë në mbrojtje dhe përkrahje të qëndrimeve ekskluziviste dhe duke fermentuar rrugë të reja, më të drejta, më fatlume për të gjithë.<sup>51</sup>

Akcesi kristian dhe evropian ndaj muslimanëve, si individ, organizatë, si fqinjë ose si pakicë, nuk janë vetëm nën ndikim të historisë dhe fotografive të trashëguara, çfarë nuk mund të krahasohet me fuqitë tjera botërore, por edhe si rezultat i drejtpërdrejtë i dhunës e cila “nuk qëndron në periferi të historisë evropiane, por është një përbërës i

<sup>49</sup> Shih: Milazim Krasniqi, Dhuna dhe qytetërimi perëndimor, Shkup, 2006, fq. 33 e tutje.

<sup>50</sup> Sipas: Teaching Islam Makes Berlusconi Shudder, në: The Daily Telegraph, 29. 03. 2006, dhe në versionin elektronik: <http://www.nysun.com/article/30020>.

Sipas të njëjtit burim, qytetet italiane viteve të fundit kanë ndërruar strukturën demografike në mënyrë dramatike. Numri i të huajve në Itali në vitin 2003 ka arritur në 3.3 milionë, që përbën 5.7 % të popullsisë italiane.

<sup>51</sup> J. Nielsen, op. cit., fq. 326-327.

rëndësishëm i kulturës perëndimore<sup>52</sup>. Kjo është e qartë dhe nuk ka dyshim, ndaj shtrohet pyetja si të përmirësohen këto raporte.<sup>53</sup> Ndonëse është punë e vështirë mendojmë se duhet më shumë mirëkuptim, arsimim dhe aftësim edhe të laikëve edhe të personelit fetarë dhe akses i drejtpërdrejtë në zgjidhjen e problemit.

Në pamundësi që në këtë shkrim të analizohen të gjitha opcionet për daljen nga kriza mund të konstatojmë se “të gjitha palët e interesuara duhet të ruhen nga pozicionet absolutiste dhe ekskluziviste të cilat nuk lënë hapësirë për jetesë në paqë dhe për jetesë kreative të përbashkët.”<sup>54</sup>

---

<sup>52</sup> Gerhard Armanski, Epoka e re, Prishtinë, 2001, sipas: Milazim Krasniqi, op. cit., fq. 38. Lexo edhe faqet vijuese të kësaj vepre frymëzuese dhe analitike.

<sup>53</sup> J. Nielsen, op. cit., fq. 328-329.

<sup>54</sup> J. Nielsen, op. cit., fq. 330-332.

### Literatura:

1. Adnan Silajdžić, *Islam u otkriću kršćanske Evrope*, Sarajevë, 2003.
2. Ahmed Shelebij, *Mewsuatu't-tarih'il-islamijji we'l-hadaret'ilislamijjeti*, pjesa V, botimi IV, Kairo, 1979.
3. Aleksandar del Val, *Islamizam i Sjedinjene države alijansa protiv Evrope*, Beograd, 1998.
4. Alija Izetbegovic, *Islam izmedju Istoka i Zapada*, Beograd, 1988.
5. Fikret Karčić & Enes Karić, *Šerijatsko pravo u savremenim društvima*, Sarajevë, 1998.
6. Filip Hiti, *Istorija arapa*, botimi II, Sarajevë, 1988.
7. G & J. Testas, *Inkvizicija*, Zagreb, 1982.
8. Halil Inalxhik, *Perandoria osmane 1300-1600*, Gjilan, 2003.
9. Hisham Xhait, *Evropa dhe Islami*, Shkup, 2004.
10. John L. Espozito, *Oksfordska historija islama*, Zenica, 2005/ 1426 h.
11. Milazim Krasniqi, *Dhuna dhe qytetërimi perëndimor /Islami si fillim i historisë/*, Shkup, 2006.
12. Nexhat Ibrahim, *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, Shkup, 1998.
13. Nexhat Ibrahim, *Islami si provokim global*, Shkup, 2006.
14. Rozhe Garodi, *Islami dhe kultura*, Sarajevë, 1990/1411 h.
15. Roger Garaudy, *Slučaj izrael*, Cenica, 1997.
16. Roger Garaudy, *Mitovi utemeljitelji izraelske politike*, Zagreb, 1998.
17. Sami Frashëri, *Përhapja e islamizmit*, Prizren, 1989/1410 h..
18. Tariq Ramadan, *Biti evropski musliman*, Sarajevë, 2002.
19. The Daily Telegraph, 29. 03. 2006, dhe versioni elektronik: <http://www.nysun.com/article/30020> .
20. The Daily Telegraph, 29.03.2006, (dhe në versionin elektronik: <http://www.nysun.com/article/30020> .)
21. Thomas W. Arnold, *Historia e përhapjes së islamit*, Prishtinë, 2004.